

Niveli i lartë- gjysmëvjetori i parë kl.V

Nxënësi/ja, respekton rregullat e sjelljes gjat orës mësimore ,po ashtu edhe gjat pushimeve.Me kujdes përcjell mësimin dhe gjithnjë inkuadrohet ne pyetje dhe përgjigje.Detyrat i kryen i/e pavarur dhe në përpikmëri.Bashkëpunon në grupe të ndryshme ,shpesh udhëheq punën në grupe.Rregulisht kryen detyrat e shtëpisë.

1.Gjuhë shqipe.- Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;identifikon një motiv në vjershën për fëmijë dhe dallon llojin e vjershës sipas motivit;njeh trajtat e përemrave vetorë në tekstin e shkruar;Identifikon elementet e një teksti në prozë;Përshkruan personazhe, peizazhe, dukuri, objekte (reale dhe të imagjinuara). Interpreton idetë në një tekst dhe shpreh qëndrimin e vet ndaj një ideje. Njeh trajtat e përemrave lidhorë në tekstin e shkruar;Përcakton gjininë dhe numrin e një mbiemri sipas numrit dhe gjinisë së emrit;njeh Ligjëratën e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë ;Krijon një lajm të shkurtër për një ngjarje;përdor mënyra të thjeshta për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet;Përdor saktë shenjat e pikësimit gjatë të shkruarit;Përdor format e sakta të shkurtesave në tekstin e shkruar;i njeh sinonimet, antonimet dhe homonimet;thekson më fuqishëm rrokjen e theksuar kur lexon dhe flet.Lektyrat me ëndje i lexon.

2.Matematikë. -Shpjegon rrafshin si sipërfaqe e rrafshët e pakufizuar;i din format 2D dhe 3D ,din për shumëkëndshat dhe diagonalet;din për trekëndëshit barakrahës, barabrinjës, brinjëndryshëm;vizaton,krahason,mat kënde dhe përcakton shkallët me këndmatës; Përshkruan forma 2D që përbëjnë një formë 3D duke përdorur madhësinë e këndeve, gjatësinë e brinjëve, drejtëzat paralele, drejtëzat normale;i din Forma 3D (rrjetë cilindrike, rrjetë prizmi, rrjetë piramidale) ;Emërton boshtet dhe kuadrantet e koordinatave në sistemin e koordinatave;din për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 1 000 000 (mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, vetia komutative dhe vetia asociative.

3. Gj. angleze- Është e shkëlqyeshme përshkruan dhe krahason njerëzit dhe sendet duke përdorur mbiemrat pronorë, përemrat pronorë, trajtat e përemrave , përemrat dëftorë dhe trajtat krahasuese të mbiemrave përshkrues njërrrokësh dhe dyrrrokësh;shpreh ide dhe njohuri,është aktiv dhe i përgaditur gjat orës mësimore,është bashkëpunues/e

4.Gj.maqedone; – tregon rezultate të shkëlqyeshme dhe është aktiv/e gjat orës mësimore;din të lexoj i pavarur dhe shkruaj fjalë dhe fjali të shkurta;i pavarur mund t’i thot numrat deri 100;dallon dhe shkruan;dallon dhe shkruan shkronjat e shkrimit të alfabetit qirilik.

5.Sh.Natyrore – shkëlqyeshëm njeh materialin e paraparë për këtë gjysmëvjetor . Gjatë çdo ore mësimore është aktiv dhe super i përgaditur. Nxënësi është i aftë të jap sqarime te detajuara per oqeanet, dukurit meteorologjike, shpjegon me përpikshmeri brezat e nxehtesis dhe organizmat e gjalle ne ato mjedise, Njeh pjeset e bimes dhe fazat e ciklit jetesor te tyre, i kushton kujdes detajeve gjatë prezentimit të punës praktike. Kryen rregullisht detyrat e shtëpisë.

6. Historia dhe shoqëria-Shpjegon, me shembull, se të drejtat themelore të njeriut burojnë nga nevojat e njerëzve për mbijetesë, zhvillim dhe përparim në shoqëri. -Tregon kur dhe ku është miratuar Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe shpjegon pse; (Konventa për të drejtat e fëmijës; -Njeh situatat e shkeljes së të drejtave të veta dhe të të drejtave të të tjerëve. -Tregon ku dhe kur u shfaqën njerëzit e parë.

7.Arsim muzikor Lexon parlato një ushtrim i thjeshtë melodik duke emërtuar tonet me takt. Këndon me takt një ushtrim të thjeshtë melodik. Përsërit njësi të shkurtra ritmike duke dëgjuar. Merr pjesë në lojëra muzikore duke kënduar dhe luajtur instrumente muzikore për fëmijë. Kryen lëvizje me ritmin e saktë, tempon, orientimin e saktë në hapësirë, duke reaguuar ndaj dinamikës, tempos, artikulimit dhe dallimeve në njësitë muzikore.

8. Arsim figurativ,- Përdor mjete të ndryshme dhe sipërfaqe për pikturim; Dallon tonet dhe ngjyrat, i kombinon dhe bën figurë; .Paraqet një kontrast komplementar i ngjyrave të ngrohta/të ftohta dhe ngjyrave të errëta/të ndritshme;;Përdor programe kompjuterike për të ndërtuar një vizatim.

9.Arsim teknik dhe informatikë.Din t’i tregoj të gjithë definicionet,i njeh pjesët qendrode,pajisjet hyrëse dhe dalëse të kompjuterit,din veç e veç për llojet e pajisjeve periferike të kompjuterit.

10. AFSH Kryen ushtrime komplekse për formësim të gjith trupit në qëndrime dhe pozicione të ndryshme; Kryen teknikën e duhur të ecjes dhe vrapimit gjimnastikor në ritëm dhe takt; Kryen teknikën e saktë “qiri”, “urë” dhe peshore ballore; Kryen teknikën e duhur rrotullim përpara dhe prapa; Kryen teknikën e duhur të qëndrimit në duar duke mbështetur këmbët në mur; •Kryen teknikën e duhur të varjes dhe lëkundjes së pajisjeve gjimnastike (ripstol, bosht të ulët, hallka, shtylla me dy lartësi).

11.Lënda zgjedhore futbollit- Din se si realizohet dhënia dhe pranimi i topit ;udhheqja e topit gjuajtja në port; manovrimi dhe driblimi; Aplikimi i rregullave të mësuara në lojë,gjithashtu din për lojën në futboll të vogël;lojra të lira me top.

Niveli i mesëm- gjysmëvjetori i parë kl.V

Nxënësi/ja, respekton rregullat e sjelljes gjat orës mësimore ,po ashtu edhe gjat pushimeve.Me kujdes përcjell mësimin dhe gjithnjë inkuadrohet ne pyetje dhe përgjigje.Detyrat i kryen i/e pavarur.Bashkëpunon në grupe të ndryshme ,ndonjëherë udhëheq punën në grupe.Rregulisht kryen detyrat e shtëpisë

1.Gjuhë shqipe.

Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;identifikon një motiv në vjershën për fëmijë dhe dallon llojin e vjershës sipas motivit;njeh trajtat e përemrave vetorë në tekstin e shkruar;Identifikon elementet e një teksti në prozë;Përshkruan personazhe, peizazhe, dukuri, objekte (reale dhe të imagjinuara). Interpreton idetë në një tekst dhe shpreh qëndrimin e vet ndaj një ideje. Njeh trajtat e përemrave lidhorë në tekstin e shkruar;Përcakton gjininë dhe numrin e një mbiemri sipas numrit dhe gjinisë së emrit;njeh Ligjëratën e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë ;Krijon një lajm të shkurtër për një ngjarje;përdor mënyra të thjeshta për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet;Përdor saktë shenjat e pikësimit gjatë të shkruarit;Përdor format e sakta të shkurtesave në tekstin e shkruar;i njeh sinonimet, antonimet dhe homonimet;thekson më fuqishëm rrokjen e theksuar kur lexon dhe flet.Lektyrat me ëndje i lexon.

2.Matematikë - Shpjegon rrafshin si sipërfaqe e rrafshët e pakufizuar;i din format 2D dhe 3D ,din për shumëkëndshat dhe diagonalet;din për trekëndëshit barakrahës, barabrinjës, brinjëndryshëm;vizaton,krahason,mat kënde dhe përcakton shkallët me këndmatës,por jo me një precizitet të lartë;i din forma 3D (rrjetë cilindrike, rrjetë prizmi, rrjetë piramidale) ;Emërton boshtet dhe kuadrantet e koordinatave në sistemin e koordinatave;din për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 1 000 000 (mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, vetia komutative dhe vetia asociative)

3. Gj.angleze-, Shumë mirë përshkruan dhe krahason njerëzit dhe sendet duke përdorur mbiemrat pronorë, përemrat pronorë, trajtat e përemrave të gjatë, përemrat dëftorë dhe trajtat krahasuese të mbiemrave përshkrues njërrrokësh dhe dyrrrokësh.

4.Gj.maqedone; Nxënësi/ja.tregon rezultate solide;din të lexoj dhe shkruaj fjalë dhe fjali të shkurta.Din numrat deri 100;njeh dhe shkruan shkronjat e shkrimit të alfabetit qirilik,me pak gabime.

5.Sh.Natyrore – Njeh oqeanet, shpjegon faktoret klimatik dhe dukurit meteorologjike,me pak vështirësi identifikon dhe përshkruan kafshët dhe bimët dhe brezat e jetesës së tyre. Përshkruan ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në mjedis. Njeh dhe emërton pjesë të bimëve dhe me pak ndihmë përshkruan fazat e ciklit jetësor te bimës.

6. Historia dhe shoqëria.- Shpjegon, me shembull, se të drejtat themelore të njeriut burojnë nga nevojat e njerëzve për mbijetesë, zhvillim dhe përparim në shoqëri. -Tregon kur dhe ku është miratuar Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe shpjegon pse; (Konventa për të drejtat e fëmijës; -Njeh situatat e shkeljes së të drejtave të veta dhe të të drejtave të të tjerëve;bën përpjekje të tregoj ku dhe kur u shfaqën njerëzit e parë.

7.Arsim muzikor.- Lexon parlato një ushtrim i thjeshtë melodik duke emërtuar tonet me takt. Përpiqet të këndoj me takt një ushtrim të thjeshtë melodik. Përsërit njësi të shkurtra ritmike duke dëgjuar. Merr pjesë në lojëra muzikore duke kënduar dhe luajtur instrumente muzikore për fëmijë. Kryen lëvizje me ritmin e saktë, tempon, orientimin e saktë në hapësirë.

8. Arsim figurativ.- Përdor mjete të ndryshme dhe sipërfaqe për pikturim; Dallon tonet dhe ngjyrat, i kombinon dhe bën figurë; .Paraqet një kontrast komplementar i ngjyrave të ngrohta/të ftohta dhe ngjyrave të errëta/të ndritshme;interesoheq të përdorë programe kompjuterike për të ndërtuar një vizatim.

9.Arsim teknik dhe informatikë. - I din t'i tregoj të gjithë definicionet,i njeh pjesët qendrode,pajisjet hyrëse dhe dalëse të kompjuterit;me pak ndihmë të arsimtarit e tregon mënyrëne punës të pajisjeve periferike.

10. AFSH-•Kryen ushtrime komplekse për formësim të gjith trupit në qëndrime dhe pozicione të ndryshme; Kryen teknikën e duhur të ecjes dhe vrapimit gjimnastikor në ritëm dhe takt; Kryen teknikën e saktë “qiri”, “urë” dhe peshore ballore; Kryen teknikën e duhur rrotullim përpara dhe prapa; Përpiqet të realizoj teknikën e duhur të qëndrimit në duar duke mbështetur këmbët në mur;

11.Lënda zgjedhore futbollit.-Din se si realizohet dhënia dhe pranimi i topit ;udhheqja e topit gjuajtja në port; manovrimi dhe driblimi; Aplikimi i rregullave të mësuara në lojë,gjithashtu din për lojën në futboll të vogël;lojra të lira me top.

Niveli i ulët- gjysmëvjeteri i parë kl.V

Nxënësi/ja, respekton rregullat e sjelljes gjat orës mësimore ,po ashtu edhe gjat pushimeve.Me kujdes përcjell mësimin dhe gjithnjë inkuadrohet ne pyetje dhe përgjigje.Detyrat i kryen me vështirësi.Bashkëpunon me një grupe të caktuar të nxënësve në,punën me grupe.Ndonjëherë i kryen detyrat e shtëpisë.

1.Gjuhë shqipe Lexon rrjedhshëm;Me vështirësi dallon trajtat e përemrave vetorë në tekstin e shkruar;Identifikon elementet e një teksti në prozë; Interpreton idetë në një tekst dhe shpreh qëndrimin e vet ndaj një ideje. Njeh trajtat e përemrave lidhorë në tekstin e shkruar;Përcakton gjininë dhe numrin e një mbiemri sipas numrit dhe gjinisë së emrit;njeh Ligjëratën e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë ;Krijon një lajm të shkurtër për një ngjarje;përdor mënyra të thjeshta për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet;Përdor saktë shenjat e pikësimit gjatë të shkruarit;Me gabime të vogla përdorë format e sakta të shkurtesave në tekstin e shkruar;i njeh sinonimet, antonimet dhe homonimet.

2.Matematikë-Me ndihmën e mësimdhënësit shpjegon rrafshin si sipërfaqe e rrafshët e pakufizuar;i din format 2D dhe 3D ,din për shumëkëndshat dhe diagonalet;din për trekëndëshit barakrahës, barabrinjës, brinjëndryshëm;vizaton,krahason;me vështirësi mat kënde dhe përcakton shkallët me këndmatës; Përshkruan forma 2D që përbëjnë një formë 3D duke përdorur madhësinë e këndeve, gjatësinë e brinjëve, drejtëzat paralele, drejtëzat normale;din për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 1 000 000 (mbledhësi, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi, vetia komutative dhe vetia asociative) Vazhdimisht i duhet ndihma e mësimdhënësit.

3. Gj. angleze-, Me vështirësi, përshkruan dhe krahason njerëzit dhe sendet duke përdorur mbiemrat pronorë, përemrat pronorë, trajtat e përemrave , përemrat dëftorë dhe trajtat krahasuese të mbiemrave përshkrues njerëroqësh dhe dyrëroqësh.Vazhdimisht I duhet ndihma e mësimdhënësit.

4.Gj.maqedone; – Nxënësi/ja.ka njohuri themelore nga ajo që ka mësuar,me ndihmën e mësimdhënësit lexon dhe shkruan fjalë dhe fjali të shkurta,me ndihmën e mësimdhënësit shkruan dhe mban mend shkronjat e shkrimit të alfabetit qirilik.I duhet ndihma e arsimtarit.

5.Sh.Natyrore – Nxënësi nuk shpreh interesim gjat orës mësimore, ka vështirësi të jep sqarime themelore oqeanet dhe dukurit meteorologjike. Në mënyrë të përgjithshme shprehet për aktivitetet e realizuara gjat punës praktike por ka nevoj për ndihmën e arsimtarit dhe nxënësve gjatë punës në grupe .Ka vështirësi të identifikoj pjesët e bimëve dhe fazat e ciklit jetësor të bimës.

6. Historia dhe shoqëria.- Shpjegon, me shembull, se të drejtat themelore të njeriut burojnë nga nevojat e njerëzve për mbijetesë, zhvillim dhe përparim në shoqëri. -Tregon kur dhe ku është miratuar Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe shpjegon pse; (Konventa për të drejtat e fëmijës; -Njeh situatat e shkeljes së të drejtave të veta dhe të të drejtave të të tjerëve. I duhet ndihma e arsimtarit.

7.Arsim muzikor.- Lexon parlato një ushtrim i thjeshtë melodik duke emërtuar tonet me takt. Këndon me takt një ushtrim të thjeshtë melodik. Përsërit njësi të shkurtra ritmike duke dëgjuar. Merr pjesë në lojëra muzikore duke kënduar dhe luajtur instrumente muzikore për fëmijë. Kryen lëvizje me ritmin e saktë, tempon, orientimin e saktë në hapësirë, duke reaguar ndaj dinamikës, tempos, artikulimit dhe dallimeve në njësitë muzikore.Shpesh kërkon ndihmën e arsimtarit.

8. Arsime figurativ,- Përdor mjete të ndryshme dhe sipërfaqe për pikturim; Dallon tonet dhe ngjyrat, i kombinon dhe bën figurë; Paraqet një kontrast komplementar i ngjyrave të ngrohta/të ftohta dhe ngjyrave të errëta/të ndritshme

9.Arsime teknik dhe informatikë.. Me shumë vështirësi tregon definicionet;i njeh një pjesë të pajisjeve periferike periferike.Me ndihmën e arsimtarit i tregon mënyrën e punës të pajisjeve periferike.

10. AFSH Kryen ushtrime komplekse për formësim të gjith trupit në qëndrime dhe pozicione të ndryshme; Kryen teknikën e duhur të ecjes dhe vrapimit gjimnastikor në ritëm dhe takt; Kryen teknikën e saktë “qiri”, “urë” dhe peshore ballore; Kryen teknikën e duhur rrotullim përpara dhe prapa; Kryen teknikën e duhur të qëndrimit në duar duke mbështetur këmbët në mur;

11.Lënda zgjedhore futbollit- Din se si realizohet dhënia dhe pranimi i topit ;duhëqja e topit gjuajtja në port; manovrimi dhe driblimi; Aplikimi i rregullave të mësuara në lojë,gjithashtu din për lojën në futboll të vogël;lojra të lira me top.